



VENDIM

Nr. 104, datë 18.08.2015

PËR

**LICENSIMIN E SHOQËRISË “LENGARICA & ENERGY” SH.P.K,
NË AKTIVITETIN E TREGËTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE**

Në mbështetje të neneve 16 , 37 pika 2, gërma “d”, dhe 110 të Ligjit 43/2015 “Për sektorin e energjisë eklektike”, nenit 4 pika 1 gërma “g”, neni 5 pika 2 dhe neneve 13 dhe 14 të “Rregullores për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të Plotë/Pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave”, të miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve Nr. 108, datë 09.09.2008, Bordi i Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 18.08.2015, mbasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria “LENGARICA & ENERGY” sh.p.k. si dhe relacionin e Drejtorisë së Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit për liçensimin në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

Konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë “LENGARICA & ENERGY” sh.p.k., plotëson tërësisht kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për Procedurat e Liçensimit, Modifikimit, Transferimit të plotë/ të pjesshëm dhe Rinovimit të Liçensave” si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2 gërmat “a”, “b”, “c”, “d”, “e”), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Të dhënat specifike sipas tipit të licensës (neni 9, pika 4./10 gërmat “a”, “b” dhe “c”) janë plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër Bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të licensojë shoqërinë “LENGARICA & ENERGY” sh.p.k, në aktivitetin e tregëtimit të energjisë elektrike, për një afat 30 vjeçar.
2. Drejtoria e Liçensimit, Monitorimit të Tregut dhe të të Licensuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s

Petrit AHMETI

I